

URDHËR
Nr. 63, datë 27.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; si dhe Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratuar me urdhrin e Komisionerit nr. 46, datë 16.2.2024, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për nënshkrimin e akteve administrative me karakter të përgjithshëm në kompetencë të titullarit/Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas legjislacionit të zbatueshëm dhe rregullores së institucionit, te znj. Blerta Nerguti, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 30.3.2026 deri më datë 3.4.2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët e përgjithshëm pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
Besnik Dervishi